



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 153/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterit në shenjën e trafikut në rrugë publike (rrethrotullim), për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5150 (pesëmijënjëqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 03.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën ankesë theksohet se subjekti politik LDK me datën 03.10.2013, në Rr.Ramadan Rexhepi ka vendosur posterin e kandidatit për kuvend të komunës në shenjën e komunikacionit, në hapësirën publike, në rrethrotullim, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Rregullës zgjedhore nr.11/2013, Kodi i Mirësjelljes për subjektet politik, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, neni 4.1 pika b. Parashtruesi i ankesës kërkon që të ndërmerren masa ligjore, konform rregullave në fuqi.  
Ankesës i ka bashkangjitur si provë fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 04.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.10.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik, në të cilën theksohet se ankesën e ushtruar e vlerësojnë si të pabazë, nga fakti sepse nga fotoja e ofruar si provë nuk ka fare datë, si dhe kandidati i LDK-së e as dega e LDK-së, nuk kanë dijeni lidhur me këtë poster, dhe sipas këtij subjekti në përgjigjen në ankesë theksojnë se kanë dyshim se posterit është i vendosur nga dikush tjetër që nuk i përket LDK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Sipas parashtruesit të ankesës, subjekti politik LDK, ka vendosur posterin e kandidatit për kuvend të komunës, në shenjen e komunikacionit, në rrugë publike (rrethrotullim), i cili veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara të subjekteve politik, që kanë të bëjnë me vendosjen e njoftimeve, pllakateve, dhe posterëve, në lidhje me fushatën zgjedhore, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nga fotografia e ofruar si provë, e cila i është bashkangjitur shkresave të lëndës nga parashtruesi i ankesës, shihet qartë se poster i kandidatit për kuvend të komunës, Nuredin Retkoceri, nga radhët e subjektit politik të LDK-së, është vendosur në shenjen e trafikut, në rrugë publike (rrethrotullim), të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

Prandaj duke pasur parasysh se nga ana e subjektit politik LDK, është bërë shkelje e nenit 33 pika b) e LZP-së, neni 4.1 pika b), të Rr.Zgjedhore Nr.11/2013, ngase poster i subjektit në fjalë është vendosur në rrugë publike (rrethrotullim), në shenjen e trafikut, si dhe duke marrë parasysh faktorët e cituar me lartë, për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 153/2013 më datën 05.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Nehat Idrizi**

#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*